



# PRI 2021

## TITUJT

**Editorial:** Qeverisja e përgjegjishme [faqja 1](#)

**KOVID-19:** Përgjigje dhe aktivitete të tjera  
të KB [faqja 2](#)

**Raporti Vjetor i Resultateve të OKB 2020**  
[faqja 3](#)

**Në fokus:** Qeverisja lokale [faqja 4](#)

## DATAT KYÇE

### MARS

- 28 Dërgesa e parë e vaksinave të blera përmes mekanizmit  
KOVAKS është pranuar

### PRILL

- 7 Dita Botërore e Shëndetësisë dhe fillimi i fushatës së  
OBSH-së për barazi në shëndetësi.
- 8 Dita Ndërkombëtare e Romëve
- 8 Maqedonia e Veriut shénon 28 vjetorin e anëtarësimit të  
plotë në Kombet e Bashkuara.
- 21 Në kuadër të Marrëveshjes së Parisit, Maqedonia e  
Veriut me mbështetjen e UNDP-së ia dorëzoi UNFCCC-së (Korniza e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet  
Klimatike) zotimin e ri të zgjeruar mbi ndryshimet klimatike  
(82% reduktim të emetimit të gazeve deri në vitin 2030;  
8,000 vende të reja të punës, të njohur ndryshe si vende  
të gjelbra të punës dhe 47 milion euro të gjeneruara nga  
ekonomia përmes qasjes rrumbullakësuese).

- 19-23 Fillimi i Javës së Gjelbër të ILO-s (Organizatës  
Botërore të Punës) tuboi inovatorë, liderë të bizneseve,  
ekspertë të politikave dhe punonjës në sektorët e mjedisit  
njësor, me qëllim që të hulumtohen mundësitë se si do të  
duket e ardhmja e gjelbër.

- 21-28 UN Women dhe Projekti për Mundësi të  
Shëndetshme (HOPS) në partneritet me Koalicionin  
Margjinat dhe Rrjetin Nacional kundër Dhunës ndaj Grave  
dhe Dhunës në Familje, realizojnë trajnimë në internet për  
punonjësit e mediave mbi dhunën me bazë gjimore ndaj grave  
dhe vajzave.

[www.facebook.com/1un.mk](http://www.facebook.com/1un.mk)

[www.twitter.com/1UN\\_MK](http://www.twitter.com/1UN_MK)

## BULETINI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

10



## EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Pandemia KOVID-19 na e ka vënë në pah faktin se jeta në planetin Tokë është një simbiozë e interesave dhe nevojave të përbashkëta, gjegjësisht angazhimeve dhe veprimeve të përbashkëta. Ne duhet të jemi në gjendje t'i lëm mënjanë interesat individuale, ato të korporatave, interesat institucionale dhe të partive politike, për t'i ndihmuar të tjérët, me çka do ta ndihmojmë edhe veten tonë. Në botën tonë aq të ndërlidhur, virusi është përvapur me shpejtësi, duke i sfiduar hapur kufijtë dhe kontinentet edhe atë pa ndasi mes të varfërve dhe të pasurve. Për analogji, e vetmja mbrojtje universale - vaksinat - mund të jetë efektive, vetëm nëse arrinjë te të gjithë.

Sic edhe pritej ndikimi shëndetësor dhe socio-ekonomik ishte më pak shkatërrues në shqeritë më të pasura dhe në ato më pak të polarizuara dhe më të gatshme për të bashkëpunuar, pra shqeritë me institucionë funksionale që e praktikojnë qeverisjen e përgjegjishme dhe e gjëzojnë besimin e rjerzëve. Ne kemi parë shumë shembuj të veprimeve të shpejtë dhe bashkëpunuese në rrafshin global dhe atë lokal, nga shërbimet vullnetare të organizuara në komunitetet për t'u ndihmuar të moshuarve dhe më të prekshmëve, deri të shqiptjet e gjelbërtë që ofrojnë zgjidhje për ndërprenjet e zinxhirëve të furnizimit: donacionet lokale dhe rajonale që ndihuan me përgjigje mjekësore dhe, së fundmi, bashkëpunimin global që mundësoi zhvillimin dhe vënien në disponicion të vaksinave në një periudhë jaftëzakonisht të shkurtër kohore.

Për fat të keq, ne kemi parë edhe shumë shembuj të bashkëpunimit të kufizuar, të veprimeve kolektive të pamjaftueshme ose të papërgjegjishme. Përkundër përpjekjeve më të mira në rrafshin global, pabarazitë globale janë pasqyruar edhe në shpërndarjen e vaksinave: deri në fund të prillit, më shumë se 900 milion doza të vaksinave janë administruar globalisht, mësuptë mbi 81% iu janë dhënë shteteve me nivel të lartë ose mbi nivelin e mesëm të ardhurave, ndërsa vendet me të ardhura të ulëta kanë marrë vetëm 0.3%.

Përkushtimi i skajshëm dhe masive i staffit mjekësor dhe vullnetarëve ndonjëherë është vënë përballë me fotografitë e klubave dhe tubimeve të rjerzëve pa maska ose pa e respektuar distancimin fizik, gjegjësisht është vënë përballë me deklaratat politike me plot akuza të ndërsjella, në vend të veprimeve të përbashkëta, genësore dhe bashkëpunuese. Kemi parë institucionë të paralizuara dhe të pafuqishme për ta realizuar mandatin e tyre, për shkak të mungesës së konsensusit

politik, duke çuar në një mungesë të mbështetjes socio-ekonomike për ata që kanë më shumë nevojë. Mungesa e të dhënave të sakta statistikore në lidhje me ndikimin e pandemisë, vegancërisht te grupet më të rezikuara, mbutet një pengesë e rendësishme për veprimin me ndikim, gjithashtu shpesh e penguar nga korrupzioni dhe devijimi i burimeve të pakta të rimëkëmbjes. Kur shoqërohet kjo me rritjen globale dhe lokale të dezinformimit dhe lajmeve të rrreme, atëherë ndikon edhe më tej negativistë në shëndetin mendor dhe e rrit frikën e popullsisë.

Prandaj është me rendësi thelbësore që të vazhdojmë ta theksojmë dhe të demonstrojmë përmes praktikës së për planetin tonë, përvendet tonë dhe për komunitetet tonë duhet të veprojmë së bashku, me përgjegjësi dhe vetëmohim. Tani më shumë se kurri, duhet t'i lëm mënjanë mosmarrovëshjet tonë dhe të punojmë për çështje që na bashkojnë, të kërkojmë konsensus dhe ta tejkalojmë blokimin. Pasi ta kemi kapërcyer armikun tonë të përbashkët, virusin, mund të vazhdojmë të konkurrojmë me idetë dhe zgjidhjet më të mira për zhvillim të qëndrueshmë dhe të jetojmë në një botë në të cilën njerëzimi dhe pjesa tjeterë natyrës bashkëjetojnë në kohezion dhe zhvillim.

Tani në Maqedoninë e Veriut e kemi një mundësi unike për të renë dakord së bashku për një vizion të përbashkët për të ardhmen, duke formular një Strategji Nacionale të Zhvillimit për 20 vitet e ardhshme dhe duke e mbështetur zbatimin e saj. Kryesorja është që ne të ndërtojmë një perspektivë të zotëruar në nivel shtetëror, e cila e pasqyon një konsensus mes gjeneratash, ndër-partiak, ndër-ethnik, ndër-sektorial, gjinor dhe shoqëror për çështjet që ne mendojmë se janë më të rendësishmet për brezat e ardhshëm. Ne duhet të jemi inovativë, mendje hapur, të shkathët dhe bashkëpunues. Kur ta kemi këtë vizion të dakorduar dhe të përbashkët nga të gjithë, atëherë mund të fillojë konkurrenca se si ta zbatojmë atë sa më mirë. OKB-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të plotë në këtë drejtim.



**Rosana Duxhak**

Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut

# AKTIVITETET E PËRGJIGJES DHE RIMËKËMBJES NGA KOVID-19

Ajgencitë e OKB-së në vend vazhdojnë ta mbështesin përgjigjen ndaj KOVID-19 me ndërhyrje specifike dhe analiza të thelluara, të përgendruara në çështje brenda fushave të tyre përkatëse të ekspertizës.

Në fund të martsit Makedonia e Veriut e [pranoi grupin e parë të vaksinave kundër KOVID-19](#), të finançuar nga qeveria përmes mekanizmit KOVAX. Mekanizmi është si mijet për përspejtimit të qasjes në KOVID-19 bashkëdritohet nga Koalicioni për Inovacione të Gatishtërisë Epidemike (CEPI), Aleanca e Vaksinave Gavi dhe [Organizata Botërore e Shëndetësisë \(OBSH\)](#), në partneritet me [Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë \(UNICEF\)](#) si një partner kryesor zbatues, si dhe organizata e shoqërisë civile, prodhuesit e vaksinave, [Bankën Botërore](#) dhe të tjerët.

Për ta mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) në adresimin e hezitimit ndaj vaksinave dhe ndërtimin e besimit të publikut, [UNICEF-i](#) e zhvilloi dhe nisi një [fushatë komunikimi multimedial](#) për të krijuar besim te vaksinat me fokus te vaksinat kundër KOVID-19. Fushata që zhvillohet në televizioni dhe media sociale, i plotëson aktivitetet tjera në terren të drejtuara nga Qeveria. Qëllimi është të ndërtohet besim te vaksinat në përgjithësi dhe vaksinat kundër KOVID-19, duke i adresuar pengesat për pranimin e vaksinave dhe duke ndërmarrë hapa aktive për të siguruar informacione të saktë, me qëllim që të rikthehet besimi. Fushata është pjesë e aktiviteteve të përbashkëta të OKB-së të finançuar nga [Fondi i Përgjigjes dhe Rimëkëmbjes kundër KOVID-19](#). Sipas këtij projekti, [OBSH-ja](#) shpërndau një sërë videoesh në lidhje me imunizimin në gjuhën [magedonase](#) dhe [shqipe](#) përmes kanaleve të mediave sociale; ndërsa [Fondi i OKB-së për Popullsinë \(UNFPA\)](#) nisi aktivitetet përgatitore për sigurimin e shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues përmes klinikave mobile. Klinikat e tillë i synojnë të janë në shërbim të grave dhe vajzave të rezikuara në zonat që kanë disponueshmëri dhe qasje të dobët në shërbime, të përkësua edhe më tej nga pandemia e KOVID-19. Këto përgatitje e përfshijnë zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të shërbimeve mobile, që do të integrohen në sistemin e-shëndetësisë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me mbështetjen nga USAID, [UNICEF](#) dhe [OBSH](#) nisi [aplikacioni celular HealthBuddy+](#) duke siguruar qasje në informacione të azhurnuara dhe të verifikuar për

## TE DHËNAT EPIDEMIOLOGJIKE TË FUNDIT (6 maj 2021)

153,137 RASTE TË KONFIRMUARA TË KOVID-19 5,016 FATALITETE SI PASOJË E KOVID-19

84,817 DOZA TË ADMINISTRUARA TË VAKSINAVE

Raste të reja të raportuara gjatë javës



Raste të vdekjes të raportuara gjatë javës



Për të dhënat më të reja shih [covid19.who.int/region/euro/country/mk](https://covid19.who.int/region/euro/country/mk)

KOVID-19 dhe mekanizmin e informacioneve kthyese, në mënyrë që publiku të angazhohet në sigurimin e qasjes në informacionet e besueshme. Aplikimi është promovuar në kuadër të panel diskutimit "Dezinformimi dhe pandemja KOVID-19", që tuboi në një eveniment udhëheqës të mendimit për ta diskutuar "infodeminë" e KOVID-19, ku morën pjesë 135 pjesëmarrës duke përfshirë persona të rinj.

[OBSH-ja](#) dhe Ministria e Shëndetësisë e kanë zbatuar ciklin e parë të Programit të Zhvillimit Profesional, që mbulon rrëth 430 infermieri të kujdesit primar dhe mami, të cilat kanë njohuri dhe aftësi të reja për shërbime të kujdesit shëndetësor me cilësi më të mirë. Programi është zhvilluar me qëllim që të mbështetet zbatimi i modelit të ri të kujdesit shëndetësor primar në vend, të nisur në fillim të vitit 2019 dhe përshtatur ndaj sfidave dhe nevojave të sjella nga pandemja KOVID-19.

[Organizata Ndërkombëtare e Punës \(ILO\)](#) e lëshoi studimin "[Vlerësimi i Përgjigjeve të Sigurimeve Shqërore ndaj KOVID-19: Mësime nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore gjatë fazës së parë të pandemisë](#)", i cili i rishikon në mënyrë komparative masat shtetërore të sigurimeve shoqërore në përgjigje ndaj KOVID-19 në shtatë vende (Shqipëri, Bosnie dhe Hercegovinë, Moldavi, Mal të Zi, Makedoni e Veriut, Serbi dhe Ukrainë), e analizon efektivitetin e tyre dhe pasojat afatgjata dhe i diskuton sfidat e ardhshme në përmirësimin e sistemave të sigurimeve shoqërore. Raporti fokusohet kryesisht në përfitimet e parave të gatshme dhe konklidon se masat fiskale të shtatë vendave të vlerësuara, ishin përgjithësisht më të ulëta se ato të Evropës Perëndimore ose të vendave anëtare të BE-së nga Evropa Qendrore dhe Lindore dhe - me disa përsashtime - kryesisht të përgendruara në shpenzime të drejtëpërdrejtë shtesë për ndërmarrjet dhe amvisëritë. Sipas vlerësimeve të ILO-s, vlera e stimilit fiskal gjatë tremujorëve të parë të vitit 2020 ka qenë ekuivalente me 23% të orëve të humbura të punës për Evropën Jugore dhe 54% për qind për Evropën Lindore.

[Organizata Ndërkombëtare për Migracion \(IOM\)](#) ka filluar një kurs me pesë [modulë të mësimit elektronik mbi KOVID-19](#) në pikat e hyrjes, të krijuar për zyrtarët që janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me njerëzit në lëvizje. Në përpunje me udhëzimet e OBSh-së, kursi do t'i njoftojë zyrtarët me historikun, simptomat kryesore, transmetimin dhe metodat e parandalimit të KOVID-19, si dhe me bazat e ndihmës së parë psikologjike. Për më tepër, kursi do ta avancojë të kuptuarit e kornizës ligjore ndërkombëtare që e udhëheq përgjigjen e KOVID-19 në pikat e hyrjes dhe hapat kryesore për t'i zbuluar dhe menaxhuar udhëtarët e sëmurë, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të migrantëve në kontekstin e KOVID-19. Kursi është në dispozicion në anglisht në platformën e [mësimit elektronik E-Campus](#) të IOM-it dhe së shpejti do të përkthehet në gjithët kryesore lokale të Ballkanit Perëndimor.

## AKTIVITETET TË OKB-SË

Duke ndihmuar Agjencinë e Punësimit në zbatimin e Planit operacional për punësim, [Zyra e OKB-së për Shërbimet e Projekteve \(UNOPS\)](#) i mbështeti 52 persona të papunë për të krijuar kompani dhe 140 njerëz të papunë për trajnuar për profesione, për të cilat ka kërkesë të lartë.

Gjithashtu janë dhënë grante mbështetëse prej 307,000 MKD për 18 persona të papunë në të gjithë vendin. Përmes projektit Mbështetje Nordike për Progresin e Maqedonisë së Veriut, UNOPS trajnoi rrëth 600 nëpunës civilë nga institucionet përkatëse neveritare në aspekte të ndryshme të procesit të aderimit në BE, gjë që u realizua në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatin për Çështje Evropiane.

[UNFPA-ja](#) i ka ofruar mbështetje eksperite Entitit Shtetëror të Statistikës në drejtim të përpjekjeve të komunikimit lidhur me Regjistrimin e vitit 2021.

[UN Women](#) e ka nisur një fushatë të mediave sociale "Si të bëhenj një qytetare aktive?", që synon ta rrisë ndërgjegjësimin përendësinë e pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarries publike në nivel lokal, së bashku me Akcija Zdruzënska, partnere në projektin e buxhetimit të përgjegjshëm ndaj gjinisë. Partneri i UN Women, Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (EJL) ishte bashkënkoiq i Forumit të Dytë të Grave Kryetare të Komunave në EJL: Zhvillim Ekonomik Lokal Përfshirës, së bashku me Kongresin e Autoriteteve Lokale nga Moldavia (CALM). Ngjarja tuboi mbi 180 pjesëmarrës, duke përfshirë kryetarë të komunave, kryetarë të këshillave të komunave, zyrtarë vendorë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, si dhe ofroi mundësi për t'i shkëmbyer praktikat më të mira për ndërryrjet lokale të përgjegjshme gjinore në EJL, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedze e Bashkëpunitit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA). Asociacioni përendimor e hulumtim (HERA) e organizoi serinë e dytë të trajnimeve përfshirës pëforcimët e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), me qëllim të ofrimit të shërbimeve të specializuara të këshillimit psiko-social për të mbijetuarit e dhunës jashtë Shkupit.

Me mbështetjen e [Programit të OKB-së për Zhvillim \(UNDP\)](#) përmes iniciativës Premtimi për Klimë, të finançuar nga BE-ja, Makedonia e Veriut e paraqiti në prill një zotim të ri të veprimtari përklimën sipas Marrëveshjes Kornizë të Parisit. Vendit është zotuar t'i zgjedhjet emetimet e gazeve serë për 82% krahasuar me nivelet e vitit 1990, për të krijuar 8,000 vende të reja pune të gjelbërtë dhe përmirësuar një qasje rrumbullakësuese, e cila parashikohet të gjenerojë 47 milion euro për ekonominë. Në kuadër të tre evenimenteve virtuale të mbajtura në prill nën hashtagun #ItsPossible (Është e mundshme) janë promovuan dhe diskutuar veprimet dhe politikat e klimës në kuadër të Kontributit të Përcaktuar Nacional me palët e interesuara nacionale.

[UNDP](#) ka filluar me zbatimin e disa projekteve rajonale në Maqedoninë e Veriut në partneritet të ngushtë me institucionet nacionale:

- projekti rajonal i finançuar nga BE-ja, që do të punojë për ta mbështetur integrimin në tregun e punës të romëve të kthyer në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në tre vjet edhe përmirësimin e klimës.
- projekti "Këshilli i Kombit" i finançuar nga UNDP, Banka Botërore, Këshilli i Evropës (KE), Iniciativa për Zhvillimin e Sipërmarrjeve Rome (REDI) dhe Roma Active Albania (RAA).

# AKTIVITETE TJERA TË OKB-së (vazhdojnë)

- Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), vazhdon t'i fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integrimit të Ballkanit Perëndimor në BE. Programi do të zbatohet në shtatë komuna partnere, të zgjedhura në periudhën e ardhshme përmes një procesi konkurrues, duke e institucionalizuar mekanizmin për financim publik të OSCH-ve në mënyrë transparente dhe të orientuar drejt zhvillimit, duke i njojur nevojat lokale dhe duke e përqafuar qasjen e bazuar në projekt.
- Qasja Institucionale e Integruar Ndërkufitarë për Luftë kundër Trafikimit të Paligjshëm të Armëve (IAT) dhe Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta (SALW), si pjesë e përpjekjeve të vazdueshme brenda Udhërrëfyesit për zgjidhje të qëndrueshme ndaj posedimit të paligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta dhe municionit të tyre në Ballkanin Perëndimor. Projekti synon ta përmirsojë bashkëpunimin ndërkufitar midis Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës\* dhe ta vendosë bazën për një qasje të integruar institucionale në luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve në dy juridiksione.

Përveç kësaj tani po përdoret, aplikacioni celular, BE SAFE, për viktimat e dhunës mbi bazë gjinore, i zhvilluar nga UNDP-ja, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe partnerët lokalë, si pjesë e një trajnimi të profesionistëve paralegalë të Projektit të Opsioneve të Shëndetshme (HOPS).

**Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugiatët (UNHCR)** mbajti dy ligjëratë për studentët e Qendrës për edukim klinik ligjor për refugiatët në Shkup dhe një ligjëratë për studentët e shkencave politike të Universitetit Amerikan College Shkup, mbi mandatin e UNHCR-së, parimet themelore në mbrojtjen e refugiatëve, dhe punën e UNHCR-së në Maqedoninë së Veriut. Këto raste ishin gjithashtu një mundësi për stafin UNHCR-së dhe studentët t'i shkëmbinë pikëpamje mbi trendet aktuale të migrimit, sfidat në mbrojtjen e njerëzve dhe potencialin e Maqedonisë së Veriut si një vend i azilit.

**Zyra e OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC)** i mbështeti autoritetet nacionale për ta: përmirësuar mbledhjen e të dhënave për armët e zjarrit përmes përdorimit të pyetësorit të UNODC-së për qarkullimin e paligjshëm të armëve (IAFQ); përmirësuar zbatimin e Udhërrëfyesit Rajonal kundër Korruptionit dhe Financave të Paligjshme (Udhërrëfyesi Rajonal); diskutuar iniciativën e re për administrim të pronës së sekuestruar, projekt rajonal i Ballkanit Perëndimor që synon ta rrisë kapacitetin e juridikioneve të adresuara për t'i rikthyer të ardhorat dhe përfitimet e krimit. Po ashtu janë ndërmarrë aktivitete për avancim të veprimit të e përbashkët UNODC-BE për kontrollin e zgjeruar të kufirit, me vlerësimin fizik të Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit në funksion të krijimit të një Task Force të Përbashkët të Aeroportit për ndalesa (JAIF) për ta themeluar një pjesë të grüpit të përbashkët ndërmjet agjencive të aeroportit, i përbërë nga një njësi JAIF dhe një njësi e Kontrollit të Transportit Ajror (ACCU).

**OBSH-ja** e organizoi një tryezë të rrumbullakët, duke sjellë së bashku përfaqësuesë të qeverisë, partnerë ndërkombëtarë

të OKB-së, shoqatat profesionale, pacientët dhe organizatat e shoqërisë civile për t'i diskutuar gjetjet e raportit mbi “Njerëzit e moshuar dhe gasja në kujdesin shëndetësor në Makedoninë së Veriut”. Raporti i theksion informacionet e disponueshme në nivel nacional, demografinë e këtij grupi të popullsisë, ceneshmërinë e tyre dhe kushtet specifike shëndetësore, si dhe nevojën për të arritur mbulim shëndetësor universal dhe transformimin e shërbimeve shëndetësore, duke punuar drejt një kujdesi më të përqendruar, të integruar dhe të përqendruar te personi.

Festimi i përbashkët i Ditës Botërore të Shëndetësisë këtë vit (7 prill) u organizua nga **OBSH-ja** së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë, **Koordinatorin e Përherëshëm të OKB-së**, **UNICEF-in**, **UN Women** dhe **UNFPA-n**, nën temën “Ndërtimi i një bote më të drejtë dhe më të shëndetshme”. Me këtë rast, **OBSH-ja** e filloj një fushatë të mediave sociale me dëshmi nga rreth 30 individë të njojur përritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e pabarazive shëndetësore. Faza e parë e fushatës do të zgjasë deri në fund të majit.


## Rindërtimi më i mirë - rezultatet e OKB 2020

**Raporti Vjetor i Resultateve të OKB 2020** e theksion kontributin e OKB-së në Maqedoninë së Veriut dhe rezultatet nga puna në pesë zona thelbësore dhe përgjigjen ndaj shëndetit dhe ndikimit socio-ekonomik të pandemisë COVID-19. Në vitin 2020, **24 agjenci të OKB-së** u angazhuan në aktivitete zhvillimore në vend, përmes zbatimit të drejtëpërdrejtë dhe ofrimit të ndihmës teknike, zhvillimit të kapaciteteve, përfitimit të partneriteteve, mobilizimit social, njoftimve për ndërmjetësim dhe pilotimit dhe shkallëzimit të inovacioneve me më shumë se 200 vende partnere. Aktivitetet e OKB-së me buxhet prej 40.1 milion dollarë, nga të cilat 35.8 milion dollarë janë shpenzuar (89% shkalla e realizimit) janë bërë të mundshme për shkak të kontributeve bujare të partnerëve ndërkombëtarë dhe lokalë, dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut.

Në krye të planeve ambicioze të vitit 2020 - përfundimi i ciklit të zbatimit të Partneritetit për Zhvillim të Qëndrueshëm (PZhQ) 2016-2020, përspejtimi i aktivitetave drejt arritjes së Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZhQ) deri në vitin 2030 dhe planifikimi i përbashkët me partnerët dhe njerëzit e Maqedonisë së Veriut përvitet në vijim - puna e OKB-së në vend ka qenë e ndikuar shumë nga KOVID-19. OKB-ja e përkrahur me vendosmëri Qeverinë me përgjigje të menjëhershme ndaj KOVID-19 përmes riprogramimit, koordinimit dhe mbështetjes logistikë, si dhe me politikat, aspektet afatgata dhe rikuperimin, duke e arritur kulmin në Kornizën e Përgjigjës ndaj KOVID-19 (PKP).

Aspekt kryesor i punës së OKB gjatë këtij viti të vështirë ishte puna e ngushtë me qeverinë dhe partnerët tjerë përruajtjen e fokusit në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përbushjen e QZhQ-ve. Një nga rezultatet e rendësishme të kësaj ishte përgatitja dhe prezantimi i Rishikimit të parë Nacional Vullnetar (RNV) të vendit, duke e treguar angazhimin e tij të ri për Agjenda 2030, edhe gjatë kohërave të vështira.

**Përmes mundësimit të ambientit të biznesit dhe krijimit të më shumë vendeve të punës**, OKB-ja e ka mbështetur kapacitetin dhe shërbimet e zgjeruara të Agjencisë për Punësimit (AP), ndërsa gjithashtu e ka përkrahur drejtëpërsëdrejtë punësimin e 314 personave përmes masave të ndryshme, ka siguruar punë për 67% të të kthyerve e ka nisur fushatën përfundimtare të punës së zhvillimit të Strategjisë Nacionale për Zhvillimin e Balancuar Rajonal 2020-2029; mundësimin e pjesëmarrjes së drejtëpërsëdrejtë të qytetarëve në 70 (nga 81) komuna përmes “forumeve të qytetarëve”: zgjidhjet digitale të mbështetura në nivelin lokal, përfshirë pagesën elektronike të taksave dhe platformën e e-mësimit të arritshme përfundit të gjithë 1,347 këshillat komunale; fuzqizimin e kapaciteteve të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve sociale me procedurat e BE-së në lidhje me migracionin, rinnovimet e spitaleve dhe objekteve, mbështetjen e përgjigjës dhe bashkëpunimit më efektiv



bazuara në dëshmi, përfshirë masat e politikave plotësisht të zhvilluara, për reagim të menjëhershëm, të ndjekura nga një vlerësim më i plotë socio-ekonomik.

Gjatë gjithë vitit, OKB-ja gjithashtu siguroi mbështetje të drejtëpërsëdrejtë përfundimtare të punës së zhvillimit të Strategjisë Nacionale për Zhvillimin e Balancuar Rajonal 2020-2029; mundësimin e pjesëmarrjes së drejtëpërsëdrejtë të qytetarëve në 70 (nga 81) komuna përmes “forumeve të qytetarëve”: zgjidhjet digitale të mbështetura në nivelin lokal, përfshirë pagesën elektronike të taksave dhe platformën e e-mësimit të arritshme përfundit të gjithë 1,347 këshillat komunale; fuzqizimin e kapaciteteve të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve sociale me procedurat e BE-së në lidhje me migracionin, rinnovimet e spitaleve dhe objekteve, mbështetjen e përgjigjës dhe bashkëpunimit më efektiv

në adresimin e trafikimit të paligishëm në porte dhe aeroporte, luftën ndaj korrupsionit, rrjedhat e paligishme financiare dhe format tjera të krimeve të organizuara. Mbështetja teknike për procesin e miratimit të ligjit të BE-së (EU NPAA) rezultoi në 60 pjesë të legjislacionit të harmonizuar me BE; 600 nëpunës civilë të trajnuar dhe një portal i qasshëm për publikun NPAA-së.

Aktivitetet të shumta janë realizuar në suaza të **sigurimit të një cilësie më të mirë të jetës për të gjithë**, me fokus të veçantë te popullata në nevojë. OKB-ja e mbështeti reagimin e menjëherëshëm shëndetësor ndaj Kovid-19; arsimin e mesëm, reformat e mësimit gjatë gjithë jetës për të rritur dhe arsimin e vazhdueshëm cilësor përmes platformës nationale të mësimit në distancë (Edulno) për të gjithë 300,000 nxënësit gjatë Kovid-19. Po ashtu janë ndërmarrë shërbimet themelore, që iu janë ofruar familjeve me fëmijë, personave me aftësi të kufizuara (PAK), romëve dhe të moshuarët në mbi 80% të komunave; tre shërbime shqërore të sapo dizajnuara në kuadër të programit të fuqizimit të grave; dy Qendra të reja për rehabilitimin e orientuar drejt punës me 20 ndërmarrje të vogla të hapura nga PAK; shërbime të digitalizuara të azilit me 22.7% rritje të vendimeve të shkallës së parë në vitin 2020 (4.2%, në 2019) dhe aktivitetet tjera të shumta.

Në kuadër të **qëndrueshmërisë së mjedisit jetësor dhe zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat**, OKB-ja u përqendrua në mbështetjen strategjike përmëbushjen e kërkësave të vendit lidhur me raportimin e marrëveshjeve mjesdorisë shumëpërsës (ndryshimi i klimës, biodiversiteti dhe degradimi i tokës), ulja e emetimeve të gazrave serë, përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura, promovimi i bujqësisë së qëndrueshme, zvogëlimi i rrezikut të katastrofës dhe trajtimi i ndotjes së ajrit. Për shkak të pandemisë Kovid-19, u rritën aktivitetet për reagimin e menjëherëshëm të kriçës. OKB-ja e mbështeti procesin e shpalljes së një parku të ri nacional (Mali Sharr); dhe 3,000 hektarë tokë bujqësore në fazën e përparuar të konsolidimit të tokës. Sistemi i kanalizimit u ndërtua në një fshat dhe një impiant tjetër për pastrimin e ujërave të ndotura përgatit për hegjen e mbeturinave; 46 stacione hidrologjike dhe meteorologjike të reja ose të azhurnuara u shhtuan në rrjetin nacional, duke i përmirësuar kapacitetet përmirësuara të menaxhimit të përmbytjeve për 22 komuna dhe 300,000 njëz të tjera.

Nën **barazinë gjinore**, OKB-ja e mbështeti harmonizimin e ligjit të ri kundër diskriminimit me CEDAW dhe Konventenë e Stambollit të (KS); ndihmoi në hartimin e ligjit të ri për barazinë gjinore dhe dokumentet përkatëse; futjen e inkriminimeve të reja ndaj grave dhe kompensimin e financuar nga shteti përviktimat e të gjitha formave të krimeve të dhunshme, përfshirë dhunën me bazë gjinore (DhBG) dhe dhunën në familje; si dhe Planin e 2-të nacional të veprimit për Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Parimet e përgjegjishme gjinore u përfshinë në projektiljin e buxhetit organik, dhe 14 ministri dhe 21 komuna u mbështetën me politika dhe buxhetet "të krijuara". Po ashtu u mbështeti avokimi gjinor dhe ndërtimi i kapaciteteve për 263 gra; 14 organizata bazë; 2 shqata të autoriteteve lokale dhe mbi 50 OSHC për buxhetimin gjinor dhe DhBG.

Buxheti i përgjithshëm i strategjisë pësë-vjeçare të OKB-së u mbyll me 130 milion dollarë (107% e planifikuar). Një vlerë shtesë prej 30 milion dollarësh u mobilizua dhe u transferua në vitin 2021 për zbatimin e KBHQ-së dhe për t'i mbështetur përparsësitë strategjike nacionale, reformat dhe procesin e anëtarësimit të vendit në BE, me fokus të veçantë për të siguruar që askush të mos ngel pas.

## NË FOKUS Qeverisja lokale

"E gjithë politika është lokale". Një sërë dekadash pasi ky vrojtim është shpalosur në Kongresin Amerikan, përsëri ka ngel një shprehje e zakonshme midis politikanëve dhe politikëbërësve, duke pranuar që suksesi i politikave lidhet drejt përsëdrejt me atë sesa ato i adresojnë shqetësimet e thjeshta, të zakonshme dhe të përditshme të qytetarëve, të cilat shpesh janë të kufizuara në nivelin lokal. Mirëpo, a vlen ende kjo deklaratë në një botë gjithnjë e më të globalizuar, që përballet me sfida planetare si pandemitë dhe ndryshimet klimatike? Nëse e marrim parasysh sesi çështjet lokale, rajonale, nacionale dhe globale janë të ndërlidhura mes vete, ekziston një argument i fortë se politikat lokale dhe zhvillimi lokal janë po aq të rëndësishëm sot sa kanë qenë më parë, në mos edhe më shumë. Çështjet si pabarazia, varfëria dhe ndryshimi i klimës mund të ndikojnë në të gjithë botën, por ato dalin nga një matricë e çështjeve të ndërlidhura lokale dhe rajonale, që nuk mund të anashkalohen në përpjekjet e zhvillimit që kërkojnë t'i tejkalojmë qëndrueshmë sfidat globale të sotme. Zhvillimi ekonomik lokal kur bëhet në mënyrë korekte, mund të jetë po aq i rëndësishëm për zbutjen e efekteve të ndryshimit të klimës ose për uljen e varfërisë, aq sa janë edhe veprimet ndërkombëtare të klimës dhe marrëveshjet tregtare.

Në mënyrë të përshtatshme, politikat dhe strategjite e reja lokale dhe rajonale janë bërë më të ndjeshme ndaj kontekstit, me tendencën për ta stimuluar qasjen proaktive të komuniteteve lokale drejt zhvillimit të qëndrueshmës dhe ardhmërisë së tyre ekonomike, sociale dhe politike. Këto qasje të reja i theksojnë dimensionet e cilësisë kundrejt atyre të sasisë, siç është zgjedhja midis një numri më të ulët të vendeve të punës me cilësi më të lartë, në raport me një numër të lartë të vendeve të reja të punës. UNDP-ja i mbrojti dhe mbështetë format e zhvillimit rajonal, që i marrin në konsideratë dimensionet cilësore, duke argumentuar se barazia më e madhe sociale dhe financiare dhe cilësia e përmirësuar e jetës në rajone është po aq e rëndësishme sa rritja e nivelit të pasurisë dhe të ardhurave, numrit të vendeve të punës, disponueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve.

Politika e zhvillimit rajonal që synon sinkronizimin e përparsësive të zhvillimit të Maqedonisë së Veriut me standartet e BE-së po përballet me sfida të shumta në frymën e prirjeve të reja socio-ekonomike, kriçës së zgjatur të shëndetit publik dhe debatit të vazhdueshëm përcaktimin e objektivave. Fokusi mbetet në zhvillimin e ekwilibruar, ndonëse me një përkufizim të zgjeruar të barazisë, që has pabarazi gjinore dhe intra-rajonale. Duke shkuar më tej, politika e zhvillimit rajonal duhet të vë theks më të madh në tejkalinim e hendekut të zhvillimit midis komuniteteve në një rajon të vetëm, sesa kryesisht në përqendrimin i burimeve në adresimin e pabarazive ndërrajonale. Në Shkup, një rrugë e vëtreme ndan Qendrën, komunën më të zhvilluar në vend sipas **Indeksit të Zhvillimit Komunal të UNDP-së**, nga Shuto Orizari, një nga komunitatet më pak të zhvilluara urbane.

Mënyra si i përgjigjet politika këtyre sfidave do të përcaktojë trajektorë të zhvillimit lokal dhe rajonal në vend. Zgjedhja është midis rishpërndarjes së thjeshtë me mbështetjen financiare për rajonet më pak të zhvilluara, zgjidhjeve më të gjera përfkasitetin, rritjen dhe konkurrencën në të gjitha rajonet, të pavarura nga niveli i tyre i zhvillimit ose një kombinim i të dyave.

**19.6%**

**19.5%**

**22.3%**

janë të kënaqur me aktivitetet e komunës për ta rritur punësimin

janë të kënaqur me përpjekjet e komunës për ta promovuar dhe stimuluar zhvillimin ekonomik lokal

janë të kënaqur me mbështetjen e komunës për NVM-të lokale

Të tre treguesit shënojnë rritje të vogël krasuar me sondazhin e bërë në vitin 2019.

Burim: IPSOS. Raporti i sondazhit të opiniot publik mbi kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet lokale (korrik, 2020)

### Strategjia e sapo miratuar për Zhvillimin Rajonal 2021-2031

dhe ligji i ri për zhvillimin e balancuar rajonal e demonstron një përpjekje të dukshme për ta përmirësuar mirëgenien e njerezve dhe standardet e jetesës në të gjitha llojet e komuniteteve, duke nisur nga qytetet e deri te zonat rurale, dhe për të rritur kontributin e tyre në suksesin e përgjithshëm të shtetit. Politika e re e theksori rëndësinë e pjesëmarrjes më të gjërë në proceset e zhvillimit, futjen e forumeve rajonale për përcaktimin e përparsësive të zhvillimit rajonal dhe vënien e një fokusi të veçantë në konkurrencën rajonale, duke e promovuar potencialin e papërdorur të të gjitha rajoneve, në vend të përqendrimit tradicional në rajonet më të dobëta. Për herë të parë, politika i identifikon zonat urbane si përfitues të veçantë.

Programi i ri për Decentralizimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshmë Lokal 2021-2026 e njeh rëndësinë e qasjeve inovative dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimit ekonomik lokal së bashku me nevojen për rritjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e qëndrueshmës të vëtëqeverisjes lokale.

Me përpjekjet e UNDP-së për avokim, këto dy dokumente kryesore nacionale për herë të parë e konsiderojnë Agjenden 2030 si kornizë për ta formuar, përmirësuar dhe zbatuar politika të zhvillimit lokal dhe rajonal dhe për ta vendosur bazën për integrimin e gjinisë në vendimarrje dhe në projektet e zhvillimit rajonal, në përputhje me politikat e zhvillimit të BE-së. Mbështetur nga donatorët (SDC, SIDA, BE, Slovacia), UNDP vazhdon ta mbështesë zhvillimin e qëndrueshmës dhe të barabartë lokal dhe rajonal përmes mbështetjes së politikave, ndërtimit të kapaciteteve për përmirësimit të ofrimit të shërbimeve dhe ndërryjeve të drejtëpërdrejtë në infrastrukturën lokale për të përmirësuar jetën e qytetarëve. **Platforma e-njohuri** tashmë e ka zgjeruar mësimin digital për këshilltarët në të gjitha 81 komunitet: ndërsa mekanizmi i Forumeve të Komunitetit ka fuqizuar rreth 7,000 qytetarë nga 24 komuna, që të angazhojnë në planifikimin e zhvillimit lokal, duke rezultuar me 33 ndërryje në infrastrukturën lokale në përputhje me përparsëtë e përcaktuara nga komuniteti.

Për t'iu përgjigjur në mënyrë sistematike këtyre përparsësive komplekse të zhvillimit, njësitet e OKB-së duhet ta kombinojnë ekspertizën e tyre të specializuar për ta pasuruar dialogun dhe koordinimin ndër-sektorial midis institucioneve nacionale në mbështetje të ndërryjeve të qëndrueshme, ndër-sektoriale të qeverisë.

Versioni i fundit të Buletinit të Zhvillimit të Qëndrueshmës është në disponicion uebfaqen e KB të Maqedonisë Veriore. Për informacion shtesë, ju lutemi kontaktoni [rc-northmacedonia@un.org](mailto:rc-northmacedonia@un.org). Prodhuar nga Zyra e Koordinatorit të Përhershëm KB në Maqedoninë e Veriore | 10 maj 2021